



**Institucioni Arsimor Privat
Gjimnazi Cambridge - Pejë**

**RREGULLORE
PËR KALENDARIN E PUNËS
EDUKATIVE-ARSIMORE**

Pejë, 2020

Bordi drejtues i shkollës së mesme Gjinnazi Cambridge - Pejë aprovoi këtë:

RREGULLORE PËR KALENDARIN E PUNËS EDUKATIVE – ARSIMORE

Me këtë Rregullore përcaktohet kalendari i punës edukative – arsimore në shkollën e fillore dhe të mesme Gjinnazi Cambridge në Pejë (në tekstin e mëtejshëm: Gjinnazi) sipas viteve shkollore.

Qëllimi Neni 1

1.1. Me kalendarin epunës së gjinnazit përcaktohet:

- Fillimi dhe mbarimi i vitit shkollor;
- Kohëzgjatja e procesit mësimor;
- Pushimet shkollore;
- Pushimet për festat publike;
- Segmente tjera të punës.

1.2. Punët në gjinnaz do të afatizohen për tu realizuar gjatë një viti kalendarik dhe shkollor.

Kohëzgjatja e vitit shkollor Neni 2

2.1. Viti shkollor akademik në Gjinnazin “Cambridge” fillon me 1 shtator të viti vijues kalendarik dhe mbaron me 31 gusht të vitit pasues.

2.2. Kalendari i punës së gjinnazit do të detajizohet për çdo vit shkollor sipas ditëve, javëve, muajve dhe semestrave (gjysmëvjetorëve), ku do të përcaktohen ditët mësimore, ditët e punës, pushimet javore, të festave, të semestrave dhe pushimi vjetor (veror e dimëror). Bazë për t`u detajuar kalendari i punës do të merret ai i MASHT-it të Kosovës për secilin vit shkollor veç e veç.

Pushimet shkollore Neni 3

3.1. Gjatë një viti shkollor në gjinnaz parashihen këto pushime shkollore:

- (a). Pushimi javor, i cili nënkupton pushimin gjatë vikendit (përveç të shtunave punuese);
- (b). Pushimet e festave (shtetërore, fetare etj) të përcaktuara në nivel të vendit;
- (c). Pushimet semestrale: i vjeshtës, i dimrit dhe i pranverës.
- (d). Pushimi i verës.

3.2. Të gjitha pushimet shkollore të gjimnazit do të harmonizohen me kalendarin e punës të MASHT-it të Kosovës i cili bihet për çdo vit shkollor akademik

Festat publike

Neni 4

Në kuadër të gjimnazit përcaktohen këto festa publike gjatë të cilave nuk do të punohet:

- 28 Nëntori – Dita e Flamurit;
- Bajrami i Madh;
- Bajrami i vogël;
- Pashkët;
- Vitit i Ri dhe
- 1 Maji.

Segmentet (aktivitetet) tjera të punës

Neni 5

Gjatë vitit shkollor në gjimnaz do të realizohen 10 ditë pune, të shtuneve, për aktivitetet e ndryshme shkollore, ku përfshihen (por jo detyrimsht) aktivitete kulturore e sportive, si dhe shëtitje, vizita dhe ekskursione me karakter rekreativ e mësimor-njohës. Kalendar i këtyre aktiviteteve do të përcaktohet me planin dhe programin e punës së gjimnaz për çdo vit shkollor veç e veç.

Neni 6

Përveç mësimin të rregullt, Kolegji për nxënësit do të organizojë edhe mësimin praktik dhe praktikën profesionale për nxënësit e profileve dhe drejtimeve profesionale, i cili do të përfshihet në planin vjetor të punës për secilin vit shkollor veç e veç.

Drejtori
Jakup Beqaj